



“Krizë Shëndetësore 2020” a mjafton ky emër për këtë krizë ?!


Nga Ardian Lekaj

Po ecim në kohën e paparashikuar dhe të papritur, pikërisht kur vëmendja tërhiqej nga strategjia afatgjatë e BE-se 2050, për një ekonomi të gjelbër dhe inovative. Duket si një histori e pabesueshme. Një shok i cili ka ndryshuar mënyrën e të jetuarit, të menduarit apo të çdo sjellje. Çdo mendje mundohet të kërkojë të shohë, se çfarë do të ndodhë nesër. Shëndeti i individit, është ushqimi i ekonomisë! Ky duhet të jetë fokusi i kamerës së çdo vendi të globit sot.

Individin e shëndoshë dhe ekonominë e lidhin një sërë hallkash duke filluar nga të dhënat evidente, masat globale në shëndetësi, zhvillimet teknologjike, kërkimi dhe koordinimi ndërkombëtar, duke vijuar me të gjithë indikatorët që formojnë mirëqenie për njerëz të shëndetshëm, si punësimi, investimet, rritja ekonomike dhe tregu. Shumë analistë i referohen krizës së vitit 2008, 12-vite më parë, por që kjo e sotmja, nuk është krizë financiare, kjo është një sëmundje që po prek trurin dhe zemrat e njerëzve. Kjo krizë po nxjerr fare mirë në pah dobësitë e sistemit fiskal, shëndetësor dhe administrativ, që zor se do ta rikthejë atë çka kombet sot po humbasin për minimalisht një dekadë. Po të shqyrtojmë këtë Botë të Re sot, me atë të nesërme pas kësaj katastrofe globale që po jetojmë me pasojat e COVID-19, do të na duhet të riorientohemi edhe pse me gjasa vështirësitë do të jenë jo të vogla, por që sigurisht do të kërkojmë dhe do të gjejmë ekuilibra të rinj:

Në këtë periudhë kur njerëzit po humbasin arsytimin, duket sikur po mësojmë si të marrim frymë, sa afër duhet të rrimë me njëri-tjetrin, si duhet të takohemi e të përshëndetemi. Është pikërisht një solidaritet nacional dhe një patriotizëm i ri brenda vendeve, të shpallur në gjendje lufte, por që armiku është i përbashkët dhe virtual.

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



Tregtia, Produktiviteti dhe Rritja Ekonomike

Çfarë duhet bërë që tregtia të luajë rolin e saj nxitës dhe mbështetës lidhur me produktivitetin dhe rritjen ekonomike në kushtet e një aktiviteti të ngadalësuar ekonomik?

Mbështetje e kërkesës dhe nxitjes së kreditimit shoqëruar me reforma strukturore që nxisin produktivitetin;

Integrim tregtar i thelluar dhe intensifikim i proceseve liberalizuese për të bërë të mundur uljen e kostove të tregtisë;

Marrëveshje lidhur me sistemin rregullator, reduktimi i pengesave në tregtinë e shërbimeve dhe fuqizim i komplementaritetit midis tregtisë dhe investimeve;

Masa politike për mbështetjen e programeve ritrajnuese dhe kualifikuese, mbështetjen e lëvizjeve profesionale dhe gjeografike me qëllim uljen e kostove për grupe të caktuara sociale në sektorë të kërcënuar nga importi, si rezultat i proceseve integruese tregtare.

Sipas WEF 2019, nëpërmjet nxitjes së produktivitetit dhe inovacionit që buron nga ekspozimi i firmave ndaj konkurrencës ndërkombëtare, ekspertizës dhe teknologjisë, bëhet e mundur edhe kalimi në hallkat e sipërme të vlerës së shtuar duke bërë që tregtia dhe hapja ekonomike të konsiderohen burime zhvillimi.



Nëse nuk shisni dot produkte, shisni informacion – Si mund të forcohet një biznes gjatë kësaj periudhe pandemie?

[> Link <](#)



“International Finance Corporation” po merr masa mbështetje të goditjes ekonomike që vjen nga COVID19

[> Link <](#)

Java ne lajme



Banka Qëndrore Europiane prezanton një paketë emergjence për të lehtësuar ndikimin e pandemisë

[> Link <](#)



Bankat shtojnë sensibilizimin për Online Banking

[> Link <](#)



A mund të infektohemi nga paratë?

[> Link <](#)



Biznesi qeverisë: Ja 20 masa lehtësuese që mund të merren në kuadër të situatës së krijuar nga COVID-19.

[>Link <](#)

Vendime qeverie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Në kuadër të përballimit dhe kapërcimit të situatës së shkaktuar nga COVID 19, Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimet në Buxhetin e Shtetit për Vitin 2020 nëpërmjet aktit normativ "Për ndryshime në ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i cili bën të mundur alokimin e një Pakete Financiare prej 12 miliardë lekë për përballimin të situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19.

Ky akt normativ alokon fondet buxhetore drejt financimit të sektorit të shëndetësisë për pajisje, medikamente, matës mjekësorë dhe shërbimet e tjera të nevojshme, si dhe financimin e paketave sociale, në kuadër të saj.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet në Buxhetin e vitit 2020 synojnë mbështetjen e shtyllave bazë të përpjekjeve të pasojave të COVID 19, duke siguruar:

6.5 miliardë lekë Fond për Paketën Sociale anti-COVID" në mbështetje të punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të pritura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi duke përfshirë shtresat në nevojë, personat që humbasin punë në komunitetet, që do të rezultojnë më të dëmtuar;

2.5 miliardë lekë Fond në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Strukturave Spitalore, për të siguruar furnizimin me medikamente, aparatura dhe urgjenca të ndryshme dhe në mbështetje të stafëve mjekësorë;


1 miliard lekë në drejtim të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, për krijimin e hapësirës për financimin e shpenzimeve domosdoshme me karakter të paparashikuar, për muajt në vijim;

2 miliard lekë rialokim drejt një Fondi Emergjence për të siguruar furnizimin me ushqim të komuniteteve të caktuara, që rezultojnë të prekura nga pandemia, apo për familje me ndihmë ekonomike dhe pensionistë të vetmuar që do të kenë nevojë për ndihmë direkte.

Vendimi i plotë këtu:

<http://www.financa.gov.al/njoftim-per-shtyp-2/>

Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	116.56	+1.79
Euro	EUR	128.17	+2.77
Poundi Britanik	GBP	142.33	+5.37
Franga Zvicerane	CHF	120.96	+2.99
Jeni Japonez (100)	JPY	107.12	+2.84
Dollari Australian	AUD	70.68	+2.35
Dollari Kanadez	CAD	82.68	+1.83

Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.



Official partner website:

www.monitor.al



Official partner website:

<http://www.yellowpagesalbania.com>

